REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Nr.10138 prot. Lushnjë, më 12.11.2025

RELACION

"PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET BASHKISË LUSHNJË DHE AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, NË ZBATIM TË VKM-SË NR. 435, DATË 26.06.2024 "PËR NJË SHTESË NË V.K.M NR.867, DATË 10.12.2014 "PËR PROCEDURAT E BASHKËPUNIMIT NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE".

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Këshilltarë!

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 435, datë 26.06.2024 " Për një shtesë në VKM- në me Nr. 867, datë 10.12.2014 " Për procedurat e bashkëpunimit në Institucionet e Administratës Shteterore", Bashkia Lushnjë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit në kuadër të trajtimit me prioritet dhe përfundimit të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban.
Ky bashkëpunim është realizuar nëpërmjet marrëveshjes përkatëse të nënshkruar midis ASHK dhe Bashkisë Lushnjë, referuar modelit përkatës, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 435, datë 26.06.2024 " Për një shtesë në VKM- në me Nr. 867, datë 10.12.2014 " Për procedurat e bashkëpunimit në Institucionet e Administratës Shteterore". Në kushtet e përfundimit të afatit 1-vjeçar të marrëveshjes së sipërcituar dhe në vijim të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarisë administrative në kuadër të trajnimit me prioritet dhe përfundimit të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban, në të cilat evidentohet një numer i konsiderueshëm ndërtimesh pa leje, është i domosdoshëm vijimi i këtij bashkëpunimi.
Me anë të shkresës me Nr. 13178/1 prot., datë 29.10.2025, protokolluar pranë Bashkisë Lushnjë me Nr.9699 prot., datë 31.10.2025, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka dërguar kërkesën për vijimin e bashkëpunimit, ku bashkëlidhur saj është dhe marrëveshja e bashkëpunimit për këtë procedurë.
Në nenin 5 dhe 6 të kesaj marrëveshje është përcaktuar mënyra se si do bashkëpunojnë dy institucionet. Në pikën 4 të nenit 5 me titull "të caktojnë burime njerezore të nevojshme për administrimin efikas të procesit administrativ" dhe pika 2, neni 6, Bashkia Lushnjë ka transferuar pranë ASHK-së, Drejtoria Vendore Lushnjë, specialist nga burimet njërëzore të saj në funksion të realizimit të kësaj marrëveshjeje.
Në gërmën "c", pika 2, neni 6, të kësaj marrëveshjeje përcaktohet vlerësimi i krijimit të njësisë përgiegjëse dhe përcaktimi i stafit që do të përfshihet në administrimin e këtij procesi.

Bashkia Lushnjë e ka krijuar këtë njësi të përbërë nga katër specialistë dhe ka vijuar punën për identifikimin e objekteve informale në të gjithe territorin administrativ të saj.
Gjithashtu, në VKM –në Nr. 435, datë 26.06.2024 " Për një shtesë në VKM-në me Nr. 867, datë 10.12.2014 " Për procedurat e bashkëpunimit në Institucionet e Administratës Shtetërore" dhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit shprehet qartë se Bashkia Lushnjë është institucioni që do përcaktojë zonat prioritare.
Afati i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi me Agiencine Shtetërore të Kadastrës do të jetë deri në 31 Dhjetor 2028.
Për sa me sipër kërkojmë nga ana juaj miratimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.

Bashkëlidhur këtij relacioni do të gieni VKM Nr. 435, datë 26.06.2024 "Për një shtesë në V.K.M me Nr. 867, date 10.12.2014 "Për procedurat e bashkëpunimit ne Institucionet e Administratës Shtetërore" dhe shkresën me Nr.9699 prot., datë 31.10.2025.

Faleminderit për mirëkuptimin!

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT
Enejd DHAMO

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.10138/11 prot. Lushnjë, më 12.11.2025

PROJEKT – VENDIM

NR 104 DATË 12/11/2025

" PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET BASHKISË LUSHNJË DHE AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, NË ZBATIM TË VKM-SË NR. 435, DATË 26. 06. 2024 "PËR NJË SHTESË NË V.K.M NR.867, DATË 10.12.2014 "PËR PROCEDURAT E BASHKËPUNIMIT NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ____/____/2025 ,sipas relacionit të paraqitur në mbështetje të nenit 111 pika 1,nenit 112, pika 2, nenit 113, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 8, pika 1, nenit 9, pika 1, nënpika l.l,shkronja"a"neni 55,pika 6, neni 64 *"Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë "*, shkronja"b"të ligjit nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar, V.K.M-së nr.435 datë 26.06.2024 *"Për një shtesë në VKM nr.867,datë 10.12.2014 "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e Administratës Shtetërore"* ju:

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Lushnjë dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me afat deri më datë 31.12.2028.
2. Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT
Enejd DHAMO

KRYETARI I BASHKISË
ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE